

Ate ku po xhirohet një film i ri

Rudolf Marku

Njihem që në rrugët e qytetit tim me një djalë të vogël të gjallë, me lëvizje të natyrshme. Hyn në bisedë pa ndrojtje, tamam si të ish moshatari im. Më drejtohet me këto fjalë:

- Ju, mësues jeni?

- Po, - i them, - po pse, si ju lindi kjo pyetje?

- E di çfarë? - më thotë. - Do të më lejoni të hyj në klasën tuaj sa për të dëgjuar një orë mësimi? Vetëm një orë mësim!

- Po përse të vish në orën time, - i them, - Ti nuk shkon vetë në shkollë?

- Puna është, - thotë ai, - se jemi duke xhiruar një film. Mua më intereson të shoh sa më shumë nxënës. Kam rolin e një nxënësi...

Quhet Ilij Çelia. Është aktori kryesor në filmin e ri që po xhiron kinostudioja «Shqipëria e Re». Është po ai që kemi parë edhe në filmin «Qyteti më i ri në botë». Takoj regjisorin Ismail Zhabjaku. Ka kohë që punon në Kinostudio. Edhe herë të tjera ka marrë pjesë në xhirim filmash, si asistent regjisor, ndërsa tani ndryshon puna. Është vetë regjisor, prandaj është më tepër i shqetësuar, studjon planet e ndryshme, vendos një grup nxënësish në një kënd të oborrit të shkollës, pastaj skicon diçka mbi një letër. E pyes:

- Cili është mendimi juaj mbi filmin «Lumë drite» që po xhironi tani?

- S'di si të them, - më thotë me të qeshur, - për këtë pyesni të tjerët.

Filmi po xhirohet në fshatin Kallmet të Lezhës, në shkollën tëvjeçare të fshatit. (Të mendojmë për një çast se më parë ky fshat ka qenë qendër e ndikimit të kishës katolike. Ndërsa tani fëmijët e fshatarëve marrin pjesë gjallërisht edhe në krijimin e filmave plot jetë. Triumf madhështor i revolucionit!)

- Një film pedagogjik? - pyes drejtorin e grupit të xhirimit Adriatik Beqirin.

-Jo, - më thotë ai, - një kuptim i tillë i filmit do të ishte tepër i ngushtë. Skenaristi Agim Çerga sigurisht që ka pasur një ide më të gjerë. Vërtet se në qendër të filmit vihet fati i një nxënësi të shkollës, Adushit, i cili nën punën këmbëngulëse të mësuesit të tij, Bardhit (aktori Ymer Bala), arrin t'i kapërcejë të metat e dobësitë e natyrës së tij dhe të hyjë, kështu, përfundimisht në rrugën e edukimit të plotë revolucionar të fëmi-

jëve tanë, por megjithatë kuptimi i filmit mund të dalë i plotë qoftë edhe me këto fjalë... Ja, dëgjoni...

I afrohemi kamerës së xhirimit. Para kamerës është aktori Ymer Bala. Zhvillohet ky dialog:

Agroni: Nuk përgjigjemi ne për të gjithë nxënësit e rrethit.

Bardhi: Puna me njerëzit tanë është art!

- Pikërisht, fjalët e fundit japin edhe kuptimin e gjithë filmit, - thekson regjisorin I. Zhabjaku. - «Në punën time - thotë ai, - kam parasysh, në mënyrë të veçantë, talentet e reja amatore. Në këtë film marrin pjesë dy aktorë mësues. Si të thash, ata në këtë film lozin vetveten. Jam i kënaqur në mënyrë të veçantë nga loja e talentuar e mësueses së shkollës së Kallmetit Zana Dema. Në fillim, kur erdhëm, nuk na e priste mendja se talenti do të gjendej kaq «i gatshëm» edhe këtu. Mjafton një sy i kujdesshëm dhe njeriu, në realitetin tonë të ri, zbulon gjëra kaq të mrekullueshme».

Takoj aktorin e trupës profesionale të Shkodrës, Ymer Balën. Nuk është hera e parë që këtë aktor të ri të talentuar e kemi parë në skenat dhe ekranet tona.

- Cila është, sipas jush, e veçanta e këtij filmi në krahasim me filmat e tjerë të xhiruar para këtij? Ç'mund të thoni ju mbi këtë film? - e pyes.

- Ymeri s'e ka të vështirë të përpërgjigjet.

- Njihem me këtë zonë, sepse kam punuar dhe në brigadat kulturore shumë vite më parë, - thotë ai. - Më ka ndihmuar në mënyrë të veçantë kolektivi i mësuesve të shkollës së fshatit. Gati çdo ditë i kam vajtur një mësuesi në orë të mësimi (ai jep këtu mësim, dhe quhet Ndue Preka), që të kap kështu refleksat e mësuesit, të gjej lëvizjet e natyrshme, detajet, mënyrën e komunikimit me nxënësit.

Ndërsa në tërësi filmi ka më tepër karakter psikologjik, këtu zë vend më tepër monologu i brendshëm, ritmi i brendshëm. Në rolin tim, vazhdon bisedën Ymeri, më ka ndihmuar së tepërmi roli i Ismet Sali Bruçajt, të cilin e kam luajtur në skenën e teatrit. Kisha për të shtuar edhe diçka - thotë ai. - Më pëlqen loja e aktorëve amatorë, në mënyrë të veçantë loja e Zana Demës, arsimtare nga Lezha, që luan për herë të parë në film.

-Po ndonjë vërejtje keni? - i them unë.

- Si të them, - thotë ai, - Kur ende nuk ka përfunduar një punë, procesi gjithnjë shkon nga korigjimi drejt përsosjes. Në korigjojmë vazhdimisht puzën tonë. I gjithë kolektivi diskuton mbi çdo plan të xhiruar. Në diskutim thërritëm edhe fshatarët, edhe kolektivin e arsimtarëve.

Ja, më së fundi, edhe operatori Petraq Lubonja. Petraqin e njoha gjatë punës. Njëri shumë i lëvizshëm, kërkues, për të gjetur më së miri këndin e duhur të veshurimit. «Unë kam xhiruar edhe filmin «Qyteti më i ri në botë». Edhe në këtë film, ajo që kam më tepër parasysh është synimi për të ruajtur sa më të paprekur natyrshmërinë e lojës së fëmijëve. Nga kjo pikëpamje, - thotë ai, - fëmijët janë aktorët më të këndshëm para kamerës. Mund të themi se, përtaq përket natyrshmërisë, aktorët - fëmijë na mësojnë edhe ne të rriturve».


Po këtë mendim, siç duket, ka edhe Artistja e merituar Tinka Kurti. Bile, këtë mendim ajo e ruajti edhe pas xhirimit me kamerë gjatë intervaleve të pushimit. E shohim Tinka Kurtin në biseda të ngrohta me nxënësit-aktorë, Ilirin, Çazmendin, Verën...

Mendja të shkon edhe një herë tek kujdesi i madh atëror i Partisë për talentet e reja, për hapat e mëdha cilësore të artit tonë kinematografik.

Edhe diçka tjetër. Ky film dallohet edhe se është duke u punuar në vrullin e madh të inisiativave revolucionare të shpërthyer në të gjitha fushat e jetës. Filmi po xhirohet me ritme shumë të shpejta.

- Nga fundi i korrikut besojmë se do të jetë gati, - thotë regjisorin I. Zhabjaku.

Dhe ky besim është mbështetur në fjalën dhe punën e artistëve tanë të mrekullueshëm.



Kuadër nga filmi «Lumë drite»



Çaste pune nga xhirimi i filmit.

(Fotot: N. Hatibi)

(vijon nga f. 6)

e vet emocionit i muzikës sonë folklorike, bile ky emocion bëhet më bindës dhe më i fuqishëm nga vetë struktura e ndërtimit të veprës. Simfonizmi i saj rritet dhe zhvillohet me mjete artistikisht të goditura, siç janë mënyrat e ndërtimit të frazave, kadencimet dhe vetë mbështetja modale e harmonike, në ngjyrat orkestrale etj. Por kryesorja është se gjatë zhvillimit të saj ndiqet gjithnjë nga autori me konsekuencë mënyra e ndërtimit, e marrë nga muzika popullore. Në dorën e kompozitorit kjo mënyrë e frymëzuar merr fuqi shprehëse emocionale, duke u thelluar dhe më shumë në psikologjinë e vetë popullit tonë. Kjo men-

dojmë se është arsyeja që këtë vepër, ashtu si edhe disa të tjera të Koncerteve të Majit 1975, të cilat i përmendëm më lart, e ndjekin me interes dhe e kuptojnë në çdo frazë të saj masat tona artdashëse.

Faktor tjetër, jo i parëndësishëm, për komunikimin e muzikës të dëgjuesit dhe për përhapjen e muzikës në masat është dhe interpretimi. Në kemi interpretues me përvojë, të cilët kanë krijuar traditën e interpretimit të veprave tona. Nuk është nevoja të përmendim këtu një listë të gjatë të emrave të tyre, por po mjaftohemi të theksojmë se sa shumë ato kontribuojnë për të çuar të saktë idenë e veprës tek dëgjuesi. Si shembull në këtë drejtim mjafton

të përmendim disa nga interpretuesit e veprave të Koncerteve të Majit 1975, të cilët lënë mae të drejtë mbresë tek publiku ynë, siç qenë instrumentistët që interpretuan trion «Këngët e tokës» të L. Dizdarit, Ibrahim Madhi, Muharrem Denizi dhe Anita Tartari apo interpretimi i flautistit Gjovalin Shestani në variacionet e F. Ibrahimit «Pranverë në fshatin tonë» etj.

Muzika jonë e formave të mëdha vokale dhe instrumentale po zhvillohet në përpjestime të mëdha dhe në rrugë të drejtë. Megjithatë, ende kemi për të bërë në drejtim të krijimit të veprave programatike, ose të veprave të tjera, simfonizmi i të cilave të na zbërthejë në hollësi pa-

surinë e madhe emocionale të njerëzve tanë të sotëm. Mbi këtë traditë të shëndoshë të krijuar dhe duke vënë në jetë mësimet e Partisë dhe të shokut Erver Hoxha, që na porositin se duhet të frymëzohemi vazhdimisht nga puna vigane e popullit tonë të mrekullueshëm, kompozitorët, artistët dhe interpretuesit tanë në të ardhmen do t'i japin popullit vepra dhe më me vlera ideartistike. Masat e gjera artdashëse do t'i mirëpresin dhe do t'i vlerësojnë gjithmonë veprat në të cilat pasqyrohen me partishmëri të lartë, me vërtetësi artistike dhe me një gjuhë të qartë e të kuptueshme, mendimet, ndjenjat dhe aspiratat e tyre.

GJON SIMONI